



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-CA-2024-03

**Vendosi:** **Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit**  
Gjykatëse Mishelë Pikar  
Gjykatës Kai Ambos  
Gjykatëse Nina Jorgensen

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 13 nëntor 2024

**Gjuha origjinale:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim mbi Kërkesën e Zyrës së Prokurorit të Specializuar dhe të Mbrojtësit të  
Viktimave për Zgjatje të Afatit për Dorëzimin e Dosjeve të Përgjigjeve**

---

**Zyrës së Prokurorit të Specializuar:**  
Kimbërli P. Uest

**Mbrojtjes së Pjetër Shalës:**  
Zhan-Lui Zhilisen

**Mbrojtjes së Viktimave:**  
Sajmon Loz

**PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SË APELIT** i Dhomave të Specializuara të Kosovës (përkatësisht “Paneli i Gjykatës së Apelit”, “Paneli i Apelit” ose “Paneli” dhe “Dhomat e Specializuara”),<sup>1</sup> në bazë të nenit 33(1)(c) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullës 172 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (“Rregullorja”), ka marrë në shqyrtim kërkesën e dorëzuar nga Zyra e Prokurorit të Specializuar më 6 nëntor 2024 (përkatësisht, “Kërkesa e ZPS-së” dhe “ZPS”).<sup>2</sup> Z. Pjetër Shala iu përgjigj Kërkesës së ZPS-së më 8 nëntor 2024 (përkatësisht, “Përgjigja ndaj ZPS-së” dhe “Shala” ose “i akuzuari” ose “Mbrojtja”).<sup>3</sup> Paneli i Gjykatës së Apelit ka marrë më pas në shqyrtim kërkesën e dorëzuar nga mbrojtësi i viktimave më 12 nëntor 2024 (“Kërkesa e Mbrojtësit të Viktimave”) (së bashku, “Kërkesat”).<sup>4</sup>

1. ZPS-ja kërkon zgjatjen e afatit deri më 27 janar 2025 për dorëzimin e dosjes së saj në përgjigje të dosjes së apelit të Shalës kundër Aktgjykimit të shqiptuar në çështjen KSC-BC-2020-04.<sup>5</sup> ZPS-ja parashtrohet se ekzistojnë arsye të vlefshme për miratimin e kësaj zgjatjeje “modeste” të afatit për shkak të pushimit të pritshëm të Gjykatës dhe mungesave në personel gjatë pushimit, si dhe faktit që afati për dorëzimin e dosjes së përgjigjes tani bie në periudhën e pushimit.<sup>6</sup> ZPS-ja shpjegon se është planifikuar që një numër anëtarësh të personelit të marrin lejen gjatë pushimit të Gjykatës dhe se kjo njihet në jurisprudencë si faktor për miratimin e zgjatjes së afateve.<sup>7</sup> Duke theksuar se

---

<sup>1</sup> F00011, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, 3 shtator 2024 (konfidencial, riklasifikuar si publik më 4 shtator 2024).

<sup>2</sup> F00022, Kërkesë e Prokurorisë për Zgjatje të Afatit për Dorëzimin e Dosjes së Përgjigjes, 6 nëntor 2024 (“Kërkesa e ZPS-së”).

<sup>3</sup> F00023, Përgjigje e Mbrojtjes ndaj Kërkesës së Prokurorisë për Zgjatje të Afatit për Dorëzimin e Dosjes së Përgjigjes, 8 nëntor 2024 (“Përgjigja ndaj ZPS-së”).

<sup>4</sup> F00024, Kërkesë e Mbrojtësit të Viktimave për Zgjatje të Afatit për Dosjen e Përgjigjes, 12 nëntor 2024 (“Kërkesa e Mbrojtësit të Viktimave”).

<sup>5</sup> Kërkesa e ZPS-së, para. 1, 11. Shih gjithashtu Kërkesën e ZPS-së, para. 5. Shih KSC-BC-2020-04, F00847/RED, Version i redaktuar publik i Aktgjykimit dhe Dënimit, 24 shtator 2024 (versioni konfidencial u dorëzua më 16 korrik 2024) (“Aktgjykimi”).

<sup>6</sup> Kërkesa e ZPS-së, para. 2, 4-5. Shih gjithashtu Kërkesën e ZPS-së, para. 9.

<sup>7</sup> Kërkesa e ZPS-së, para. 3-4. Shih gjithashtu Kërkesën e ZPS-së, para. 6-7. ZPS-ja vë në dukje jurisprudencë ku është konstatuar se miratimi i zgjatjes modeste të afateve për Prokurorinë ishte i përlejgur pas zgjatjes së afateve për Mbrojtjen dhe në kushtet e kapaciteteve të kufizuara të

Mbrojtjes iu dhanë gjashtë javë kohë shtesë për përgatitjen e apelit,<sup>8</sup> ZPS-ja argumenton se periudha e plotë 30-ditore e përcaktuar në Rregullore në kushte normale, jo në periudhë pushimi, është periudha “minimale absolute” që nevojitet për të përgatitur një dosje përgjigjeje të njëmendtë dhe të fokusuar.<sup>9</sup> Së fundi, ZPS-ja parashtron se kjo zgjatje afati është e nevojshme për të shmangur situatën ku ajo do të vihej në disavantazh të konsiderueshëm dhe se ndërlikimet me të cilat përballlet vijnë jo për shkak të ZPS-së, por prej ndryshimeve të përsëritura në kalendarin e parashikuar të dorëzimit të parashtrimeve.<sup>10</sup>

2. Shala përgjigjet se nuk e kundërshton Kërkesën e ZPS-së.<sup>11</sup>

3. Mbrojtësi i viktimave gjithashtu kërkon zgjatje të afatit për dorëzimin e dosjes e përgjigjes së tij ndaj dosjes së apelit të Shalës kundër Aktgjyqimit deri më 27 janar 2025.<sup>12</sup> Ngjashëm me ZPS-në, Mbrojtësi i Viktimave i referohet pushimit të ardhshëm të Gjykatës dhe mungesave në personel gjatë pushimit.<sup>13</sup> Sipas mbrojtësit të viktimave, duke pasur parasysh se Mbrojtja ngriti 14 pika për apelim, disa prej të cilave janë në fusha që ndikojnë tek të drejtat e viktimave pjesëmarrëse, zgjatja “e shkurtër” e kërkuar e afatit është si e arsyeshme, ashtu edhe proporcionale.<sup>14</sup>

---

disponueshme gjatë pushimit të Gjykatës. Shih Kërkesën e ZPS-së, poshtëshënimin 13 dhe jurisprudencën e cituar në të. Shih gjithashtu Kërkesën e ZPS-së, f. 8 dhe jurisprudencën e cituar në të. Shih më poshtë, poshtëshënimi 25.

<sup>8</sup> Kërkesa e ZPS-së, para. 9, f. 16. ZPS-ja rikujton se në çështjen *Mustafa*, Paneli i Apelit i miratoi ZPS-së dhe mbrojtësit të viktimave zgjatje afati prej dhjetë ditësh për dosjet përkatëse të përgjigjeve duke pasur parasysh zgjatjen e afatit prej tre javësh që i ishte miratuar të akuzuarit për apelin. Shih Kërkesën e ZPS-së, para. 8.

<sup>9</sup> Kërkesa e ZPS-së, para. 9. Shih gjithashtu Kërkesën e ZPS-së, para. 4. ZPS-ja argumenton se zgjatja e kërkuar e afatit i jep ZPS-së dy javë kohë nga përfundimi i pushimit të Gjykatës për përgatitjen e dosjes së saj të përgjigjes. Shih Kërkesën e ZPS-së, para. 9.

<sup>10</sup> Kërkesa e ZPS-së, para. 7. Shih gjithashtu Kërkesën e ZPS-së, para. 2, poshtëshënimet 4, 10.

<sup>11</sup> Përgjigja ndaj ZPS-së, para. 5.

<sup>12</sup> Kërkesa e Mbrojtësit të Viktimave, para. 1, 10.

<sup>13</sup> Kërkesa e Mbrojtësit të Viktimave, para. 7. Mbrojtësi i viktimave vë në dukje gjithashtu se Mbrojtja nuk e kundërshton Kërkesën e ZPS-së. Shih Kërkesën e Mbrojtësit të Viktimave, para. 8.

<sup>14</sup> Kërkesa e Mbrojtësit të Viktimave, para. 9.

4. Paneli i Apelit rikujton se më 24 korrik 2024, me kërkesë të Shalës, Paneli e zgjati afatin për dorëzimin nga Shala dhe ZPS-ja të njoftimeve të tyre për apel, nëse do të kishin, deri më 2 shtator 2024.<sup>15</sup> Më 2 shtator 2024, i akuzuari dorëzoi njoftimin e tij të parë për apel kundër Aktgjykimit.<sup>16</sup> Më 30 shtator 2024, pas udhëzimeve nga Paneli i Apelit dhe kërkesës së parë të ZPS-së, Shala dorëzoi versionin e ndryshuar të njoftimit të tij për apel ("Njoftimi për Apel").<sup>17</sup>

5. Paneli më tej rikujton se më 18 shtator 2024, Shalës iu miratua fillimisht një zgjatje afati prej dhjetë ditësh për dorëzimin e dosjes së apelit.<sup>18</sup> Më 30 tetor 2024, Paneli e zgjati më tej afatin e dorëzimit të dosjes së apelit për Shalën deri më 25 nëntor 2024, duke i dhënë kohë të mjaftueshme për ta finalizuar atë pas vënies në dispozicion të versionit përfundimtar të përkthimit të Aktgjykimit në gjuhën shqipe.<sup>19</sup>

6. Paneli i Apelit thekson se, sipas rregullës 179(2) të Rregullores, dosjet e përgjigjeve duhet të paraqiten brenda 30 ditëve nga paraqitja e dosjes së apelit, konkretisht deri më 27 dhjetor 2024. Megjithatë, Paneli rikujton se, sipas rregullës

---

<sup>15</sup> F00006, Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes për Ndryshimin e Afatit për Dorëzimin e Njoftimit për Apel, 24 korrik 2024 ("Vendimi për Ndryshimin e Afatit për Dorëzimin e Njoftimit për Apel"). Shih gjithashtu F00001, Kërkesë për Ndryshimin e Afatit për Dorëzimin e Njoftimit për Apel të Mbrojtjes, 19 korrik 2024. Më 8 gusht 2024, Paneli i Apelit hodhi poshtë një kërkesë tjetër nga Shala për zgjatje të mëtejshme të afatit për dorëzimin e njoftimit të tij për apel dhe konfirmoi se palët duhet të dorëzonin njoftimet e tyre për apel, nëse kishin, deri më 2 shtator 2024. Shih F00009, Vendim mbi Kërkesën e Mëtejshme të Mbrojtjes për Ndryshimin e Afatit për Dorëzimin e Njoftimit për Apel, 8 gusht 2024, para. 8. Shih gjithashtu F00008, Kërkesë e Mbrojtjes për një Zgjatje të Mëtejshme të Kufizuar të Afatit për Dorëzimin e Njoftimit për Apel, 7 gusht 2024.

<sup>16</sup> F00010/RED3, Version i Redaktuar Publik i Njoftimit për Apel të Mbrojtjes, 11 tetor 2024 (versioni konfidencial u dorëzua më 2 shtator 2024).

<sup>17</sup> F00017/COR/RED, Version i Redaktuar Publik i Versionit të Korrigjuar të Njoftimit të Rishikuar për Apel të Mbrojtjes, 31 tetor 2024 (versioni konfidencial i pakorrigjuar u dorëzua më 30 shtator 2024, versioni konfidencial i korrigjuar u dorëzua më 30 tetor 2024) ("Njoftimi për Apel"). Shih F00015, Vendim mbi Kërkesën e ZPS-së për Urdhërimin e Shalës për Ridorëzimin e Njoftimit për Apel, 18 shtator 2024 (konfidencial, i riklasifikuar si publik më 25 shtator 2024) ("Vendim mbi Kërkesën për Ridorëzimin e Njoftimit për Apel"), para. 16. Shih gjithashtu F00013, Kërkesë e Prokurorisë për Urdhërimin e Mbrojtjes së Shalës për Ridorëzimin e Njoftimit të tij për Apel, 9 shtator 2024 (konfidenciale, e riklasifikuar si publike më 25 shtator 2024).

<sup>18</sup> Shih Vendimin mbi Kërkesën për Ridorëzimin e Njoftimit për Apel, para. 16 (p. 8). Afati fillestar për dorëzimin prej Shalës të dosjes së tij të apelit ishte 1 nëntori 2024.

<sup>19</sup> F00021, Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes për Ndryshimin e Afatit dhe Numrit të Lejuar të Fjalëve për Dorëzimin e Dosjes së Apelit, 30 tetor 2024, para. 13, 16.

9(5)(a) të Rregullores, paneli, *proprio motu* ose nëse i tregohen arsye të vlefshme, mund të zgjasë ose shkurtojë afatet e përcaktuara prej Rregullores ose prej panelit.

7. Sa i përket dorëzimit në kohë të Kërkesave, Paneli vlerëson se ato janë dorëzuar mjaftueshëm në kohë para afatit të përcaktuar në rregullën 179(2) të Rregullores. Sa u përket arsyeve të vlefshme, Paneli i Apelit rikujton së pari se, parimisht, afatet e përcaktuara në kornizën ligjore të Dhomave të Specializuara nuk pezullohen gjatë periudhave të pushimit të Gjykatës dhe vazhdojnë të llogariten gjatë këtyre periudhave.<sup>20</sup> Gjithashtu, Paneli rikujton se, zakonisht, angazhimet në lidhje me pushimet nuk përbëjnë arsye të vlefshme për miratimin e zgjatjes së afatit.<sup>21</sup> Rrjedhimisht, palët dhe pjesëmarrësit nuk kanë automatikisht të drejtën që zgjatja e afatit të jetë e barabartë me kohëzgjatjen e pushimit të Gjykatës.<sup>22</sup>

8. Paneli rikujton se, megjithëse pushimi i Gjykatës në vetvete nuk përbën arsye të vlefshme për zgjatje të afateve, numri i kufizuar i personelit gjatë pushimit mund të jetë faktor në miratimin e tyre.<sup>23</sup> Gjithashtu, Paneli vëren se në rastin në fjalë, periudha e pushimit ndikon në numrin e ditëve të punës që kanë në dispozicion ZPS-ja dhe mbrojtësi i viktimave deri në afatin e dorëzimit të përgjigjeve përkatëse.<sup>24</sup>

---

<sup>20</sup> Shih rregullën 123(3) të Rregullores. Shih gjithashtu, p.sh. ICTY, *Prosecutor v. Brđanin*, IT-99-36-A, Decision on Motion for Extension of Time for the Filing of Prosecution Response Brief, 20 July 2005 (“*Brđanin* Decision”), p. 3 (ku Dhoma e Apelit e TPNJ-së rikujtoi se në llogaritjen e afateve për dorëzimin e parashtrimeve përfshihen edhe periudhat e pushimit të Gjykatës).

<sup>21</sup> Shih p.sh. ICTY, *Prosecutor v. Perišić*, IT-04-81-A, Decision on Momčilo Perišić’s Motion for an Extension of Time to File his Appeal Brief, 24 November 2011, p. 1. Shih gjithashtu p.sh. TPNJ, *Prokurori k. Boshkoskit dhe Tarçulovskit*, IT-04-82-A, Vendim mbi Mocionin Urgjent të Tarçulovskit për Zgjatje të Afatit të Dorëzimit të Dosjes së Kundërpërgjigjes, 16 prill 2009, p. 2; ICTR, *Nahimana et al. v. Prosecutor*, ICTR-99-52-A, Decision on Clarification of Time Limits and on Appellant Barayagëiza’s Extremely Urgent Motion for Extension of Time to File his Notice of Appeal and his Appellant’s Brief, 6 September 2005, p. 5.

<sup>22</sup> Shih Kërkesën e ZPS-së, para. 9.

<sup>23</sup> KSC-CA-2023-02, F00004, Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes për Ndryshimin e Afatit për Dorëzimin e Njoftimit të Apelit, 9 janar 2023, para. 6 dhe jurisprudencën e cituar në të. Shih gjithashtu KSC-BC-2020-06, IA030/F00003, Vendim mbi Kërkesën e Selimit dhe Krasniqit për Ndryshimin e Afatit, 22 dhjetor 2023, para. 3.

<sup>24</sup> Pushimi dimëror i Gjykatës fillon të hënën, 23 dhjetor 2024 deri të premten, 10 janar 2025. Shih gjithashtu, p.sh. KSC-BC-2023-10, IA001, F00004, Vendim mbi Kërkesën e Zyrës së Prokurorit të Specializuar për Zgjatje të Afatit, 28 dhjetor 2023, para. 3.

Rrjedhimisht, në rrethanat e veçanta në këtë rast dhe në mënyrë përjashtimore, Paneli është i mendimit se zgjatja proporcionale e afatit do t'i ndihmonte ata për të përgatitur parashtime të njëmendta dhe të fokusuara në përgjigje ndaj dosjes së apelit të Shalës.

9. Në këtë aspekt, Paneli nuk është i mendimit se zgjatja e kërkuar e afatit me një muaj mund të përshkruhet si “modeste”, siç sugjerohet nga ZPS-ja<sup>25</sup>, apo “e shkurtër”, siç sugjerohet nga mbrojtësi i viktimave.<sup>26</sup> Në fakt, Paneli konstaton se në këtë rast ajo do të ishte joproporcionale, pasi do të dyfishonte afatin e përcaktuar në Rregullore dhe do të bënte që ZPS-së dhe mbrojtësit të viktimave t'u jepej më shumë kohë shtesë për t'u përgjigjur sesa koha shtesë që iu miratua Shalës për dosjen e apelit.<sup>27</sup> Paneli më tej vë në dukje se ZPS-ja dhe mbrojtësi i viktimave ishin njoftuar që më 16 shtator 2024 për synimin e Mbrojtjes për të kërkuar zgjatje të mëtejshme të afatit për dosjen e apelit dhe për mundësinë e ndryshimit sërish të kalendarit të parashtimeve.<sup>28</sup>

---

<sup>25</sup> Paneli vëren se në vendimet e cituara nga ZPS-ja në mbështetje të pretendimit se zgjatja e afatit të kërkuar prej saj është “modeste”, megjithëse Dhoma e Apelit e TPNJ-së vlerësoi se numri i kufizuar i personelit të disponueshëm gjatë pushimit të Gjykatës përbënte arsye të vlefshme, ose (i) zgjatjet e afateve që i ishin miratuar prokurorisë ishin më të shkurtra; (ii) Mbrojtjes i ishte miratuar më parë shumë më tepër kohë shtesë ; ose (iii) Dhoma e Apelit e TPNJ-së mori parasysh faktin se prokuroria përballej njëkohësisht me disa afate apelesh. Shih *Brđanin Decision*, p. 2-4 (prokurorisë i ishte miratuar zgjatje afati me katër javë, ndërkohë që i akuzuari kishte përfituar nga një zgjatje afati prej dy muajsh për dorëzimin e dosjes së apelit dhe prokurorisë i duhej që në të njëjtën periudhë të përgatiste dosjen e një çështjeje tjetër në apel); ICTY, *Prosecutor v. Lukić and Lukić*, IT-98-32/1-A, Decision on Milan Lukić's Motion Seeking Extension of Time to File Appeal Brief and Motion for Stay of Proceedings, 30 October 2009, paras 6, 12 (prokurorisë i ishte miratuar zgjatje afatit me dhjetë ditë, po ndërkohë ajo duhet të përfundonte dosjet për çështje të tjera në apel); ICTY, *Prosecutor v. Krstić*, IT-98-33-A, Decision on Prosecution Motion for Extension of Time, 24 December 2001, p. 1 (prokurorisë i ishte miratuar zgjatje afati njëjavore, ndërkohë që data e dorëzimit të dosjeve ishte ndryshuar si rrjedhojë e dorëzimit me vonesë të kërkesës së të akuzuarit). Shih gjithashtu Kërkesën e ZPS-së, poshtëshënimi 13.

<sup>26</sup> Kërkesa e Mbrojtësit të Viktimave, para. 9.

<sup>27</sup> Paneli konstaton se Shalës iu dhanë edhe 24 ditë të tjera për përgatitjen e dosjes së apelit, jo 42 ditë, siç pretendon ZPS-ja. Shih Kërkesën e ZPS-së, para. 9, poshtëshënimi 16.

<sup>28</sup> Shih CRSPD4, Mesazh Elektronik nga Ekipi i Mbrojtjes së Shalës drejtuar NJAGJ-së për mesazhin drejtuar Panelit lidhur me F00012\_ pikat që duhen ngritur gjatë konferencës para apelit, 16 shtator 2024 (konfidencial) (ku Mbrojtja vë në dukje se ka ndër mend të paraqesë kërkesë për, ndër të tjera, zgjatje të afatit për dorëzimin e dosjes së apelit). Shih gjithashtu Transkriptin, 20 shtator 2024, f. 6-7. *Contra* Kërkesa e ZPS-së, poshtëshënimi 10.



10. Rrjedhimisht, duke mbajtur parasysh edhe tri javët shtesë që iu miratuan Shalës për dorëzimin e dosjes së apelit<sup>29</sup> – përveç 60 ditëve sipas rregullës 179(1) të Rregullores – Paneli konstaton se zgjatja e afatit me 21 ditë, konkretisht deri më 17 janar 2025 – përveç 30 ditëve sipas rregullës 179(2) të Rregullores – përligjet në rrethanat specifike në këtë rast, për të marrë parasysh në veçanti kapacitetet e kufizuara gjatë pushimit dimëror të Gjykatës. Paneli gjykon se kjo nuk do të ndikojë në mënyrë të paarsyeshme në shpejtësinë e përgjithshme të procesit.<sup>30</sup>

11. Për arsyet e lartpërmendura, Paneli i Gjykatës së Apelit:

**MIRATON** Kërkesën pjesërisht; dhe

**AUTORIZON** ZPS-në dhe mbrojtësin e viktimave të dorëzojnë dosjet e tyre në përgjigje të dosjes së apelit të Shalës deri më 17 janar 2025.

/nënshkrimi/

**Gjykatëse Mishelë Pikar,**

**Kryegjykatëse**

E mërkurë, 13 nëntor 2024

Në Hagë, Holandë

---

<sup>29</sup> Shih më lart, poshtëshënimi 27.

<sup>30</sup> Shih gjithashtu Përgjigjen ndaj ZPS-së, para. 5.